



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*DRAFT 4*

*16.04.10*

### L I G J

Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

#### PËR MBROJTJEN E MJEDISIT<sup>1</sup>

Në mbështetje të Neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:**

---

<sup>1</sup> Ky Ligj adopton parimet e mbrojtjes së mjedisit nga Tratatit të cilat janë të përbashkëta në një sërë direktivash të Acquis për mjedisin. Ai gjithashtu adopton disa perkufizime të cilat janë të përbashkëta në një sërë direktivash për mbrojtjen e mjedisit.

Ligji transponon plotësisht Direktivën 2004/35/EC Mbi përgjegjësinë mjedisore të amenduar nga Direktiva 2006/21/EC dhe Direktiva 2009/31/EC.

Ligji gjithashtu vendos mbështetjen ligjore për transpozimin e mëtejshëm të direktivave mjedisore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaritë tjera.

## Kreu 1

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

##### Qëllimi

1. Ky ligj ka per qellim mbrojtjen e mjedisit ne një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin te tij, parandalimi dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

#### Neni 2

##### Objektivat e Mbrojtjes së Mjedisit

1. Objektivat e mbrojtjes se mjedisit janë:
  - a) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit;
  - b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore;
  - c) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
  - d) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
  - e) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit; dhe
  - f) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

#### Neni 3

##### Objekti

1. Ky ligj percakton parimet, kerkesat, pergjegjesite, rregullat dhe procedurat e pergjithshme per garantimin e mbrojtjes ne një nivel të lartë të mjedisit ne Republikën e Shqiperise.

#### Neni 4

##### Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij Ligji, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:
  - a. **“Autoritet publik”** janë:
    1. qeverisja qendrore dhe vendore apo administrata të tjera publike, përfshirë organizmat këshillues publikë në nivel kombëtar, rajonal apo lokal;
    2. çdo person fizik apo juridik që ushtron funksione administrative publike, përfshirë edhe detyra, veprimtari ose shërbime specifike që kanë të bëjnë me mjedisin; dhe
    3. çdo person fizik apo juridik që ka përgjegjësi apo funksione publike, apo që siguron shërbime publike që kanë të bëjnë me mjedisin dhe jane nën kontrollin e një organizmi apo personi që përfshihet në grupimet e pikës (1) apo (2) te gërmes (a).
  - b. **“Biodiversitet”** është tërësia e organizmave të gjalla, përfshirë shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet specieve dhe ekosistemeve të një zone të dhënë;
  - c. **“Cilësi e mjedisit”** është gjendja e mjedisit apo e një perberesi te tij ne nje kohe te caktuar e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë;

- d. **“Dëmtim i mjedisit”** është dëmi apo humbja që ka pesuar funksioni natyror i mjedisit, që është shkaktuar nga dëmi apo humbja që ka pesuar ndonjë nga përbërësit e tij dhe/ose nga nderhyrjet e shkaktuara nga njeriu në bashkeveprimin mes perberesve të tij dhe rrjedhën natyrore të zhvillimit të tyre;
- e. **“Habitate natyrore”** janë zona tokësore apo ujore, të cilat dallohen nga karakteristikat gjeografike, abiotike dhe biotike, që mund të jenë plotësisht apo pjesërisht natyrore;
- f. **“Kapacitet bartes”** është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm duke ruajtur në të njëjtën kohë vetitë e tij natyrore;
- g. **“Ministria”** është Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
- h. **“Ministër”** është Ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
- i. **“Mjedis”** janë perberesit natyrore: ajri, toka, uji dhe deti, klima, bota e bimëve dhe kafshëve në tërësinë e ndërveprimeve të tyre me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu;
- j. **“Mjedis i kërcënuar”** është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnise së një ndotje të rëndësishme;
- k. **“Ndërrhyrje në mjedis”** kuptohet çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut që mund të prekë kapacitetin bartes të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose ka ndikime të tjera të dëmshme mbi mjedisin;
- l. **“Ndotje”** është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erarave të pakëndeshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë në ato masa që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale, apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet dhe përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit;
- m. **“Subjekt ndotës ose ndotes”** është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit;
- n. **“Publik”** është një ose më shumë persona fizikë apo juridikë, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre;
- o. **“Rrezik ndaj mjedisit”** është mundësia që paraqet një veprimtari njëzore për të shkaktuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, dëmtimin e mjedisit apo për të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njeriut;
- p. **“Substancë e rrezikshme”** është një substancë apo grup substancash të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar në mënyrë të natyreshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash të cilat paraqesin rrezikshmeri të ngjashme;
- q. **“Substanca”** janë elementët kimikë dhe përbërjet e tyre në gjendjen e tyre natyrore apo siç prodhohen nga industria;
- r. **“Shkarkim”** është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erarave të pakëndeshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të vecuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë si pasojë e aktivitetit njëzore;
- s. **“Zhvillues”** është çdo person fizik apo juridik që kryen ose administron një veprimtari dhe/ose të cilit i është dhënë e drejta e përfaqësimit të veprimtarisë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

## **Kreu 2**

### **PARIMET E MBROJTJES SË MJEDISIT**

#### **Neni 5**

##### **Parimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm**

1. Autoritetet publike përmes miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin ekonomik dhe shoqëror që përdor burimet natyrore në atë mënyrë që plotëson nevojat aktuale dhe ruan mjedisin pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

#### **Neni 6**

##### **Parimi i Parandalimit dhe Masave Paraprake**

1. Masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie në mënyrë që të parandalojnë apo në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis.
2. Gjatë përcaktimit të masave dhe veprimtarive specifike të mbrojtjes së mjedisit, zbatohet një qasje parandaluese me qëllim që në rast se ka kërcënime për dëme të rënda apo të pakthyeshme mbi mjedisin, mungesa e sigurisë shkencore të mos pengojë apo të mos shtyjë në kohë marrjen e masave efektive me kosto më të ulët që parandalojnë dëmtimin e mjedisit.

#### **Neni 7**

##### **Parimi i Ruajtjes së Burimeve Natyrore**

1. Autoritetet publike përmes miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve brenda kompetencave të tyre, nxisin marrjen e masave dhe veprimtarive të mbrojtjes së burimeve dhe mjedisit natyror përmes ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit, ujit, detit, tokës, pyjeve, diversitetit biologjik dhe të peizazhit natyror.

#### **Neni 8**

##### **Parimi i Zëvendësimit dhe/ose Kompensimit**

1. Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren për të zëvendësuar ndërhyrjet që mund të sjellin efekte të dëmshme mbi mjedisin me ndërhyrje të tjera që paraqesin një rrezik apo kërcënim më të vogël apo kompensojnë efektet e dëmshme të pashmagshme.
2. Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira, përdorimin e produkteve, pajisjeve dhe aparaturave, si dhe zbatimin e atyre proceseve të prodhimit, që janë më pak të dëmshme apo të pa dëmshme për mjedisin.
3. Autoritetet publike, përmes miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme mjedisore.

## Neni 9

### Parimi i Qasjes së Integruar

1. Niveli i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së tij është kusht i detyrueshëm për fillimin dhe zbatimin e çdo veprimtarie, për të siguruar që zhvillimi ekonomik të realizohet në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi i rrezikut ndaj mjedisit dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit në tërësi.
3. Autoritetet publike gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, i kushtojnë rëndësi të veçantë cënueshmërisë së mjedisit, lidhjes ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjes ndërmjet burimeve natyrore të perteritshme dhe jo të perteritshme, trashëgimisë kulturore dhe pasurive materiale, tërësisë së ndërveprimeve të tyre reciproke, si dhe ndërveprimit midis projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

## Neni 10

### Parimi i Pergjegjesise Reciproke dhe Bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit, apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.
2. Republika e Shqipërisë siguron bashkëpunimin dhe solidaritetin për zgjidhjen e problemeve mjedisore globale dhe ndërqeveritare përmes marrëveshjeve ndërkombëtare dhe shkëmbimit të informacionit mjedisor.
3. Autoritetet publike brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e veprimeve të përbashkëta midis tyre dhe subjekteve fizike dhe juridike me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

## Neni 11

### Parimi Ndotësi Pagan

1. Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit rezultojnë në ndotjen e mjedisit, mbajnë përgjegjësi financiare duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla mund të përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si edhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë edhe kostot e rehabilitimit dhe të kompensimit të personave fizike apo juridike të dëmtuar.

## Neni 12

### Parimi i Aksesit në Informacion dhe i Pjesëmarrjes së Publikut

1. Çdo person ka të drejtë t'i jepet në kohë informacion mbi gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra, në përputhje me këtë Ligj, legjislacionin të cilit ai i referohet si edhe Ligjin Nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit në lidhje me Dokumentet Zyrtare".
2. Gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike perkatese sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për: identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve dhe programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe perberësit e mjedisit si dhe në hartimin

dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve me karakter të përgjithshëm që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, vendim-marrjen për dhënien e lejeve perkatese te mjedisit në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe legjislacionin të cilit ai i referohet.

### **Neni 13**

#### **Parimi i Nxitjes se Veprimtarive per Mbrojtjen e Mjedisit**

1. Autoritetet publike brenda kompetencave të tyre, nxitin veprimtarite per mbrojtjen e mjedisit, qe parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij si edhe projekte qe ulin përdorimin e substancave te caktuara, lëndëve të para dhe energjisë, apo qe e ndotin me pak mjedisin.
2. Autoritetet publike, fusha e veprimit të të cilave përfshin funksione te lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndergjegjesimin dhe edukimin e publikut në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
3. Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre për masat vullnetare që ato mund te ndermarrin me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit ne mjedis.

### **Kreu 3**

#### **PERBERESIT E MJEDISIT**

### **Neni 14**

#### **Dispozita të Përgjithshme**

1. Perberesit e mjedisit mbrohen nga ndotja si vecmas ashtu dhe në kombinim duke pasur parasysh ndërveprimet ndermjet tyre.

### **Neni 15**

#### **Mbrojtja e Ajrit**

1. Mbrojtja e ajrit përfshin masat për mbrojtjen e perberesve dhe cilësisë së tij me synim shmangien apo reduktimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut, cilësinë e jetës dhe mjedisin në tërësi si dhe parandalimin dhe pakësimin e ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatike.
2. Masat perkatese për zbatimin e mbrojtjes së ajrit percaktohen në këtë Ligj dhe në legjislacionin e posacem.

### **Neni 16**

#### **Mbrojtja e Ujerave**

1. Mbrojtja e ujerave përfshin masat per mbrojtjen dhe permiresimin e cilesise se ujerave sipërfaqësore, nëntokësore, bregdetare, ne tranzicion dhe detin në tërësi me qëllim shmangien apo

pakesimin e efekteve të dëmshme mbi ekosistemet ujore, mjedisin në tërësi, shëndetin e njeriut, dhe cilësinë e jetës.

2. Masat perkatese për zbatimin e mbrojtjes së ujerave sipas kategorive te percaktuara ne piken 1 te ketij neni, percaktohen në këtë Ligj dhe në legjislacionin e posacem.

## **Neni 17**

### **Mbrojtja e Tokës**

1. Mbrojtja e tokës përfshin ruajtjen e cilesive dhe funksioneve natyrore të tokës, parandalimin e dëmtimit të saj, monitorimin e gjendjes së tokës dhe ndryshimet në cilësinë e saj, si dhe përmirësimin dhe rehabilitimin e tokës së dëmtuar.
2. Mbrojtja e shtreses vegetative te tokes synon mbrojtjen e aftesise per te prodhuar si dhe përmirësimin dhe rehabilitimin e saj.
3. Masat perkatese për zbatimin e mbrojtjes së tokës dhe shtreses vegetative te saj percaktohen në këtë Ligj dhe në legjislacionin e posacem.

## **Neni 18**

### **Mbrojtja e Biodiversitetit**

1. Mbrojtja e natyrës përfshin ruajtjen e biodiversitetit, ekosistemeve dhe peizazhit natyror me qellim shmangien apo reduktimin e efekteve të dëmshme mbi mjedisin, shëndetin e njeriut si dhe përmirësimin e cilesise se jetes.
2. Mbrojtja e pyjeve përfshin masat per mbrojtjen e pyjeve natyrore, pjeserisht natyrore, komplekseve pyjore dhe te tokës pyjore, rrjedhave dhe burimeve ujore, florës dhe faunës në një rajon pyjor si dhe stacioneve të gjeneve dhe farërave të varieteteve vendase të drurëve me qellim shmangien apo reduktimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin dhe mjedisin si dhe përmirësimin e cilesise se jetes.
3. Masat perkatese per zbatimin e mbrojtjes së natyrës dhe pyjeve percaktohen në këtë Ligj dhe në legjislacionin e posacem.

## **Neni 19**

### **Ndryshimet Klimaterike**

1. Ndryshime klimaterike jane ndryshimet e shkaktuara nga ndikimet antropogjenike ne sistemin klimaterik.
2. Keshilli i Ministrave nxit dhe mbeshtet perpjekjet per reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve te gazeve sere.
3. Keshilli i Ministrave nxit zhvillimin dhe perdorimin e kujdesshem te kapjes dhe ruajtjes se dioksidit te karbonit.
4. Keshilli i Ministrave nxit perdorimin e energjise se rinovueshme dhe eficences ne perdorimin e saj.
5. Masat perkatese per zbatimin e masave qe lidhen me ndryshimet klimaterike percaktohen në këtë Ligj dhe në legjislacionin e posacem.

## **Kreu 4**

### **MBROJTJA E MJEDISIT NE PROCESIN E PLANIFIKIMIT**

#### **Neni 20**

##### **Strategjite dhe Planet Mjedisore**

1. Ministria pergatit strategji dhe plane mjedisore kombetare ne menyre periodike
2. Ministria mund te pergatise strategji dhe plane mjedisore kombetare per secilin nga perberesit e mjedisit kur eshte e nevojshme.
3. Strategjite dhe planet e referuara ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni rishikohen dhe perditesohen ne menyre te rregullt sipas nevojave.
4. Keshilli i Ministrave miraton strategjite dhe planet e referuara ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni.
5. Keshilli i Ministrave miraton kerkesat specifike per zbatimin e ketij neni.

#### **Neni 21**

##### **Planet e veprimit vendore per mjedisin**

1. Autoritetet e qeverisjes vendore pergatisin plane veprimi, vendore, per mjedisin ne menyre periodike.
2. Planet e veprimit vendore per mjedisin, pergatiten ne perputhje me strategjite dhe planet e referuara ne nenin 20 te ketij ligji.
3. Planet e veprimit vendore per mjedisin rishikohen dhe perditesohen ne menyre te rregullt sipas nevojave.
4. Keshilli i autoritetit te qeverisjes vendore perkatese miraton planet e referuara ne pikat 1 te ketij neni.
6. Keshilli i Ministrave miraton kerkesat specifike per zbatimin e ketij neni.

#### **Neni 22**

##### **Planet e Zhvillimit**

1. Planet e Zhvillimit në kuptimin e këtij Ligji përfshijnë instrumentat e parashikuar ne planifikimin kombetar, vendor e ndervendor dhe planifikimin e integruar, siç percaktohet në Ligjin Nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.
2. Gjatë hartimit dhe miratimit të planeve te zhvillimit, Autoriteti Publik përkatës mban parasysh veçanërisht ndjeshmërinë e mjedisit të një zone të caktuar, kapacitetin bartes te tij, lidhjen dhe harmoninë e vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të perteritshme dhe të paperteritshme, trashëgiminë kulturore, si dhe tërësinë e ndërveprimeve midis zhvillimeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara, në mjedis.
3. Planet e zhvillimit përfshijne masa për mbrojtjen e tokës, ujerave, detit, ajrit, pyjeve, klimës, ekosistemeve, peizazhit natyror, vlerave kulturore dhe fizike, masat për menaxhimin e mbetjeve, masat per mbrojtjen kundër zhurmave, dridhjeve, ererave te pakendshme dhe zjarrit, si dhe masa të tjera që kanë lidhje me to, qe synojne mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe permiresimin e cilesise se jetes, të përcaktuara në përputhje me kete Ligj dhe në legjislacionin e posacem.



## Neni 23

### Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1. Ne perputhje me sa parashikohet ne paragrafin 2 te ketij neni, Vlerësimi Strategjik Mjedisor kryhet per:
  - a. Planet dhe programet ne fushen e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, energjitikës, industrisë, minierave, transportit, telekomunikacioneve, menaxhimit të mbetjeve, menaxhimit të ujërave, turizmit, planifikimit te territorit si edhe për planet dhe programet e zhvillimit kombetar, rajonal e vendor.
  - b. Dokumentet e planifikimit strategjik, në bazë të së cilave bëhet planifikimi i zbatimit të projekteve qe i nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sic percaktohet ne nenin 21 te ketij ligji, dhe
  - c. Planet dhe programet që mund të kenë efekt mbi Zonat Veçanërisht të Mbrojtura, siç parashikohet në aktet ligjore te posacme.
2. Planet dhe programet e referuara në paragrafin 1 te ketij neni, të cilat parashikojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel vendor dhe/apo ndryshime jo thelbësore te tyre, kërkojnë kryerjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor vetëm në rast se Ministria vlereson se ato mund të kenë efekte të rëndesishme në mjedis.
3. Planet dhe programet që nuk përfshihen në paragrafin 1 të këtij Neni, por qe përcaktojnë kuadrin për miratimin e zhvillimit të projekteve në te ardhmen, i nënshtrohen vlerësimit strategjik mjedisor vetëm në rast se Ministria vlereson se ato mund të kenë efekte të konsiderueshme në mjedis.
4. Kërkesat e detajuara për zbatimin e këtij neni percaktohen ne ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

## Neni 24

### Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një veprimtarie zhvillimi të propozuar, është vlerësimi i ndikimeve të rëndesishme të mundshme të asaj veprimtarie në mjedis.
2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryen identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin në mënyrën e duhur të ndikimit në mjedis të një veprimtarie të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, njerëzit, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjellta.
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të veprimtarisë me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis permes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.
4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi si pjesë e përgatitjeve per planifikimin e nje veprimtarie zhvillimi, para kerkimit të lejeve perkatese te zhvillimit.
5. Kërkesat e detajuara për zbatimin e ketij neni percaktohen në ligjin per vlerësimin e ndikimit në mjedis.

## **Kreu 5**

### **KONTROLLI I NDOTJES**

#### **Seksioni 1**

##### **Normat e Mjedisit**

###### **Neni 22**

###### **Normat e Cilësisë së Mjedisit**

1. Me Norme të Cilësisë së Mjedisit kuptohet përqendrimi i një ndotësi apo grupi të caktuar ndotësish në ajër, ujë ose tokë, i cili nuk duhet të tejkalohet.
2. Normat e Cilësisë së Mjedisit për ndotës apo grupe të vecanta ndotësish të secilit prej perberesve të mjedisit miratohen nga Keshilli i Ministrave. Keshilli i Ministrave vendos afate për arritjen e normave të cilësisë së mjedisit.

###### **Neni 26**

###### **Normat Teknike të Mjedisit**

1. Me Norme Teknike Mjedisore kuptohet masa, përqendrimi ose niveli i shkarkimit nga një veprimtari, të cilat nuk duhet të tejkalohen gjatë një apo më shumë periudhave kohore. Normat Teknike të Mjedisit vendosen për grupe apo kategori të caktuara substancash.
2. Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në lejen perkatese të mjedisit për një veprimtari specifike nuk duhet të jenë më pak shtrenguese se Norma Teknike Mjedisore perkatese.
3. Normat Teknike të Mjedisit në mënyrë të përgjithshme zbatohen në pikën ku bëhet shkarkimi nga objekti i veprimtarisë.
4. Normat Teknike të Mjedisit për ndotës apo grupe specifike ndotësish për perberes të vecantë të mjedisit miratohen nga Keshilli i Ministrave. Keshilli i Ministrave vendos afate për arritjen e Normave Teknike të Mjedisit.

###### **Neni 27**

###### **Kërkesat Themelore mbi Produktet**

1. Kërkesat themelore mbi produktet, makinerite, pajisjet dhe teknologjite e prodhimit që mund të rrezikojnë apo kërcënojnë mjedisin parashikohen nga kuadri ligjor për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, Kërkesat Themelore ndaj Produkteve Joushqimore dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë.
2. Atje ku është e nevojshme, këto kërkesa themelore përfshihen në lejen perkatese të mjedisit sipas Seksionit 2 të këtij Kreu.

#### **Seksioni 2**

##### **Lejet e Mjedisit**

###### **Neni 28**

###### **Lejet e Mjedisit**

1. Veprimtaritë që shkaktojnë ndotje në mjedis pajisen me lejen perkatese të mjedisit.

2. Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tre nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe mbi mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në ato mëse që mund të shkaktojë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut:
  - a. Kategoria e veprimtarive (A) për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A;
  - b. Kategoria e veprimtarive (B) për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B; dhe
  - c. Kategoria e veprimtarive (C) për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C.
3. Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tre niveleve, përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit<sup>2</sup>.

## **Neni 29**

### **Parandalimi i Aksidenteve Madhore që Përfshijnë Substanca të Rrezikshme**

1. Çdo veprimtari ku substanca dhe preparate kimike të rrezikshme janë/ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëm në mjedis apo në shëndetin e njeriut në rastin e një aksidenti madhor, i nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin dhe kufizimin e këtyre aksidenteve.
2. Masat për parandalimin e aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme përcaktohen në këtë ligj dhe në ligjin për parandalimin e aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme<sup>3</sup>.

## **Neni 30**

### **Tavanet e Shkarkimeve**

1. Republika e Shqipërisë do të marrë masat e nevojshme për të kufizuar shkarkimet kombëtare të ndotësve acidifikues dhe eutrofikues dhe prekursorëve të ozonit.
2. Për qëllimet e këtij neni me “kufi kombëtar shkarkimi” kuptohet sasia maksimale e një substance të referuar në piken 1 të këtij neni, e shprehur në kilotonë, e cila lejohet të shkarkohet nga territori i Republikës së Shqipërisë gjatë një viti kalendarik.
3. Masat e referuara në piken 1 të këtij neni, kufizojnë shkarkimet kombëtare vjetore të atyre substancave, dhe në veçanti të dioksidit të squfurit, oksideve të azotit, përbërjeve të paqëndrueshme (volatile) organike dhe amoniakut, në sasi jo më të mëdha se tavanet e shkarkimeve të miratuara për secilin nga këto substanca.
4. Kur është e nevojshme, leja përkatëse e mjedisit, sipas përcaktimit të nenin 28 të këtij Ligji, përmban kushtet që sigurojnë respektimin e kufijve kombëtarë të shkarkimeve.
5. Tavanet kombëtarë të shkarkimeve dhe masat e referuara në piken 1 të këtij neni, për mbrojtjen e efektshme të njerëzve nga rreziqet e njohura në shëndet nga ndotja e ajrit miratohen nga Këshilli i Ministrave.

## **Neni 31**

### **Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve**

1. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve përmban informacionin për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve dhe mbetjeve, vlerësimin e prirjeve të tyre, monitorimin e progresit të bërë

---

<sup>2</sup> Vini re që Ligji i propozuar po hartohet nga ky projekt.

<sup>3</sup> Vini re që Ligji në fjalë po hartohet nga ky projekt.

permes politikave dhe programeve mjedisore, te përbushjes se detyrimeve qe rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe mundeson te drejten e publikut per t'ju dhene ky informacion.

2. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotsve administrohet nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve.
3. Zhvilluesi i veprimtarive, të cilave i referohet ky nen mban, perditeson dhe i raporton çdo vit Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve në lidhje me zbatimin e këtij neni.
4. Kerkesat e detajuara per funksionimin dhe menaxhimin e Regjistrit te Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotsve, lista e veprimtarive dhe ndotesve qe jane subjekt i ketij regjistri, si dhe formulari i deklarimit te te dhenave mbi shkarkimet dhe transferimin e ndotesve nga zhvilluesit, miratohen nga Keshilli i Ministrave.

### **Seksioni 3**

#### **Masa të Tjera të Kontrollit të Ndotjes**

##### **Neni 32**

#### **Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve**

1. Menaxhimi i integruar i mbetjeve synon parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve të dëmshme te tyre mbi mjedisin si dhe perdorimin eficient te burimeve natyrore me qëllim mbrojtjen e mjedisit, te burimeve, te shëndetit të njeriut si dhe permiresimin e cilesise se jetes.
2. Masat për menaxhimin e mbetjeve përcaktohen me ligj te posacem.

##### **Neni 33**

#### **Kimikatet**

1. Mbrojtja nga efektet e dëmshme të kimikateve, përbërjeve dhe preparateve të tyre përfshin masat dhe procedurat e mbrojtjes nga efektet e tyre të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
2. Masat për zbatimin e mbrojtjes nga efektet e dëmshme të kimikateve përcaktohen me ligj te posacem.

##### **Neni 34**

#### **Substancat ozon-holluese**

1. Rregullat mbi prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozon-holluese si dhe importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve dhe pajisjeve që permbajne keto substanca miratohet nga Keshilli i Ministrave.

##### **Neni 35**

#### **Organizmat e Modifikuar Gjenetiksht**

1. Ndalohet shkarkimi i qëllimshëm ne mjedis apo hedhja në treg e Organizmave te Modifikuar Gjenetiksht qe mund të shkaktojnë efekte të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi, në përputhje me parimin e parandalimit dhe masave paraprake.
2. Ky nen nuk zbatohet për ushqimet dhe ushqimin per kafshe që përmbajnë Organizma te Modifikuar Gjenetiksht, të cilat rregullohen me ligj te posacem.

3. Rregullat e detajuara për leshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikiisht, për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, miratohen nga Keshilli i Ministrave.

### **Neni 36**

#### **Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm**

1. Ndalohet prodhimi, hedhja në treg dhe përdorimi i kimikateve dhe pesticideve që shfaqin karakteristika të ndotësve organikë të qëndrueshëm, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.
2. Lista e substancave të referuara në paragrafin 1, kontrolli i prodhimit, hedhjes në treg dhe përdorimit, përjashtimet nga masat e kontrollit dhe reduktimi, minimizimi dhe eliminimi i shkarkimit të këtyre substancave miratohet nga Keshilli i Ministrave.

### **Neni 37**

#### **Mbrojtja nga Zhurmat dhe Dridhjet**

1. Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet përfshin masat e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet, ndaj të cilave njerëzit janë të ekspozuar në veçanti në zona të banuara, në parqe publike apo në zona të tjera të qeta në zona urbane, në zona të qeta në zona rurale, pranë shkollave, spitaleve si edhe pranë ndërtesave dhe zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave dhe/ose dridhjeve.
2. Masat për zbatimin e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet përcaktohen me ligj të posaçem.

### **Neni 38**

#### **Ererat e pakendshme**

1. Mbrojtja nga ererat e pakendshme përfshin masat mbrojtëse ndaj shkarkimit të substancave me ere të pakendshme ose potencialisht të pakendshme nga aktivitetet që i gjenerojnë ato dhe ndaj të cilave ekspozohen njerëzit.
2. Masat për mbrojtjen ndaj ererave të pakendshme dhe kriteret e vlerësimit për aktivitetet e reja dhe ekzistuese me shkarkime me ere të pakendshme ose potencialisht të pakendshme apo për burimet e këtyre ererave miratohen nga Keshilli i Ministrave.

### **Neni 39**

#### **Mbrojtja nga Rrezatimi**

1. Mbrojtja nga rrezatimi elektromagnetik synon parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e rrezikut ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut si edhe ndaj mjedisit.
2. Masat për mbrojtjen nga rrezatimin elektromagnetik përcaktohen me ligj të posaçem.

**Kreu 6**  
**MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT**

**Seksioni 1**

**Gjendja e Mjedisit**

**Neni 40**

**Monitorimi i Gjendjes së Mjedisit**

1. Monitorimi i gjendjes së mjedisit është vezhgimi dhe regjistrimi sipas nje plani dhe rregulli te caktuar, i cilësisë së mjedisit dhe ndryshimeve të gjendjes së perberesve të tij. Në veçanti ai përfshin:
  - a. Cilësinë e ujërave sipërfaqësore;
  - b. Cilësinë e ujërave nëntokësore;
  - c. Cilësinë e ajrit;
  - d. Mbetjet;
  - e. Zhurmat;
  - f. Rrezatimet;
  - g. Cilesine e tokes;
  - h. Florën, faunën, biodiversitetin, pyjet;
  - i. Ndikimet e sektorëve ekonomikë mbi perberesit e mjedisit;
  - j. Monitorimin e fenomeneve natyrore dhe ndikimin e mundshëm të tyre mbi mjedisin;
  - k. Monitorimin e ndikimeve të ndotjes së mjedisit mbi shëndetin e njeriut.
1. Keshilli i Ministrave miraton Programin Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit me qellim monitorimin e gjendjes se mjedisit.

**Neni 41**

**Monitorimi i Gjendjes së Mjedisit nga Qeverisja Qendrore dhe Vendore**

1. Ne zbatim te nenit 37 te ketij ligji ngrihet Rrjeti Kombëtar i Monitorimit, i cili shtrihet ne të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit.
2. Organizimi dhe funksionimi i rrjetit dhe mënyra, procedura dhe forma e paraqitjes së të dhënave në këtë rrjet miratohen nga Keshilli i Ministrave.

3. Fondet e nevojshme për ngritjen, funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit kombëtar të monitorimit si dhe fondet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të monitorimit për bashkitë dhe qarqet sigurohen nga buxheti i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, në përputhje me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

## **Neni 42**

### **Kufizimi i Pronësisë dhe i të Drejtave të Tjera Reale për Monitorimin e Mjedisit**

1. Çdo personi fizik apo juridik, subjekti privat ose publik i kufizohet e drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi pronat në atë pjesë të saj ku vendosen objekte dhe/ose aparatura matëse për kryerjen e monitorimit të mjedisit në rastet kur mendohet që kryerja e monitorimit të mjedisit është në interes të publikut në përputhje me sa parashikohet në Ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.
2. Me qëllim kryerjen e monitorimit të mjedisit, personi i autorizuar përdor kryesisht tokën në pronësi të shtetit, atje ku nderhyrja mbi përdorimin aktual të asaj pjesë toke është minimale. Gjatë kryerjes së veprimtarive që kanë të bëjnë me instalimin e një objekti/ impianti, të tilla si aparatet dhe pajisjet matëse të referuara në paragrafin 1 të këtij Neni, personi i autorizuar minimizon nderhyrjen mbi përdorimin e asaj pjesë toke sa më shumë të jetë e mundur dhe pas kryerjes së veprimtarisë e rikthen tokën në gjendjen e saj të mëparshme.

## **Seksioni 2**

### **Monitorimi i Përputhshmerisë**

## **Neni 43**

### **Detyrimet e Zhvilluesit në Lidhje me Monitorimin e Përputhshmerisë**

1. Zhvilluesi i veprimtarive të përfshira në kategoritë (A), (B) dhe (C) të referuara në nenin 28 të këtij ligji monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij në përputhje me dispozitat e legjislacionit mbi lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.
2. Zhvilluesi i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera duke përdorur paisje dhe instrumenta të miratuara përmes procedurës për verifikimin e matjeve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit si dhe mban këto paisje dhe instrumenta në një gjendje të pershtatshme pune.
3. Zhvilluesi mund të kryejë monitorimin nëpërmjet paisjeve dhe instrumentave që ai disponon ose nëpërmjet laboratoreve shkencore të specializuara dhe të akredituar.
4. Rezultatet e vetëmonitorimit i japën autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

## Kreu 7

### INFORMACIONI MJEDISOR

#### Neni 44

##### Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor

1. Sistemi i Informacionit Mjedisor i shërben mbrojtjes dhe menaxhimit të integruar të mjedisit dhe perberesve të tij, monitorimit të zbatimit të politikave mjedisore, raportimeve të ndersjellta në nivel kombëtar dhe nderkombëtar dhe sigurimit të informimit të publikut.
2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve administron Sistemin e Informacionit Mjedisor.
3. Autoritetet Publike bashkëpunojnë me Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve me qëllim sigurimin e funksionimit të duhur të këtij sistemi. Mjetet, metodologjia dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit në lidhje me funksionimin e këtij sistemi miratohen nga Keshilli i Ministrave.
4. Sistemi i Informacionit Mjedisor përmban të dhëna dhe informacion në lidhje me gjendjen e mjedisit, ngarkesën ndotëse dhe ndikimet në mjedis, reagimin e publikut dhe veçanërisht të dhëna mbi:
  - a. gjendjen e perberesve të mjedisit, të mbledhura dhe përpunuara në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera të posaçme,
  - b. shkarkimet e ndotësve në mjedis, të perftuara nga Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve,
  - c. karakteristikat natyrore dhe fizike të perberesve të mjedisit dhe fenomenet natyrore që kanë ndikim mbi to,
  - d. mjedisin dhe perberesit e tij, të perftuara nga projekte dhe programe kërkimore dhe vlerësuese,
  - e. burimet natyrore dhe përdorimin e tyre,
  - f. zonat e përcaktuara si të mbrojtura apo rrezikuara në bazë të akteve normative të posaçme apo konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë,
  - g. ekosistemet
  - h. efektet e ndotjes së mjedisit dhe shëndetin e njeriut,
  - i. mbetjet dhe menaxhimin e tyre,
  - j. substancat e rrezikshme,
  - k. aksidentet industriale dhe ekologjike,
  - l. masat e sigurisë dhe masat që duhen marrë në rast aksidentesh,
  - m. ndotësit e mjedisit,
  - n. masat e politikave mjedisore, planet dhe programet e mbrojtjes së mjedisit,
  - o. veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit, dhe
  - p. lejet e lëshuara për kryerjen e veprimtarive ndotëse dhe përmbajtjen e tyre.



## Neni 45

### **Informimi i Publikut në lidhje me Çështjet Mjedisore**

1. Informacioni mjedisor përfshin çdo informacion të paraqitur në formë audio, vizuale, elektronike, me shkrim, ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me:
  - a. gjendjen e perberesve të mjedisit, të tillë si: ajri dhe atmosfera, uji, toka, peizazhi dhe zonat natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare dhe detare, diversitetin biologjik dhe perberesit e tij, përfshirë organizmat e modifikuar gjenetikisht, dhe ndërveprimin ndërmjet tyre;
  - b. faktorë të tillë si substancat, energjia, zhurmat, rrezatimi, vibracionet, ererat e pakendshme apo mbetjet, përfshirë mbetjet radioaktive, shkarkimet në ajër dhe ujë, si dhe shkarkime të tjera në mjedis, të cilat kane ose mund të kene ndikim mbi perberesit e mjedisit të referuar në pikën (a) të këtij neni;
  - c. masa të tilla si politikat, legjislativi, planet, programet, marrëveshjet mjedisore, si dhe veprimtaritë që kane ose mund të kene ndikim mbi perberesit dhe faktorët e referuar në pikat (a) dhe (b) të këtij neni si dhe masat apo veprimtaritë e përcaktuara për të mbrojtur keto perberes;
  - d. raportet në lidhje me zbatimin e legjislativimit mjedisor;
  - e. analizat kosto-përfitime dhe analiza të tjera ekonomike si dhe parashikimet e përdorura brenda kuadrit të masave dhe veprimtarive të referuara në pikën (c) të këtij neni; dhe
  - f. gjendjen dhe sigurinë e shëndetit të njeriut, përfshirë ndotjen e zinxhirit ushqimor atje ku është e nevojshme, kushtet e jetesës, objektet me vlera kulturore dhe arkeologjike, si dhe strukturat e ndërtuara për sa kohë që ato ndikohen apo mund të ndikohen nga gjendja e perberesve të mjedisit të referuar në pikën (a) të këtij neni ose, nga ndikimi në ato perberes i seciles prej çështjeve të referuara në pikat (b) dhe (c) të këtij neni.
2. Autoritetet publike perkatese, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të Ligjit Nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e Informimit në lidhje me Dokumentet Zyrtare", i sigurojnë publikut mundësinë për të marrë informacionin mjedisor që ato administrojnë dhe/ose mbikëqyrin.

## Neni 46

### **E drejta për të marrë dhe/ose përdorur Informacionin Mjedisor**

1. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë t'i mundësohet dhenia dhe/ose përdorimi i informacionit të disponueshëm në lidhje me mjedisin pa qenë nevoja të shfaqë një interes specifik për të.
2. Publikut i jepet informacion në lidhje me shkarkimet në mjedis. Publiku nuk duhet të ketë mundësi të kufizuar për t'ju dhënë dhe/ose për të përdorur informacionin në lidhje me shkarkimet në mjedis.
3. Procedurat dhe kërkesat e tjera të detajuara për zbatimin e këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 47

### Pjesëmarrja e Publikut dhe Publiku i Përfshirë në Vendimmarrje

1. E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së autoriteteve publike në lidhje me mjedisin përcaktohet nga Keshilli i Ministrave.

## Kreu 8

### PËRGJEGJËSIA MJEDISORE

## Neni 48

### Përgjegjësia për dëmin ne mjedis

1. Qellimi i përgjegjësisë për dëmin ne mjedis, mbeshetur në parimin ndotësi paguan është:
  - a. parandalimi dhe zhvendimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit;
  - b. rehabilitimi i mjedisit; dhe
  - c. prezantimi i masave dhe praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit.
2. Përgjegjësia për dëmin ne mjedis përcaktohet në bazë të:
  - a. dëmit të shkaktuar ne mjedis nga çdonjëra prej veprimtarive të parashikuara në piken 3 (a) të këtij neni, si dhe nga kërcënimi i mundshëm për një dëm të tillë, dhe/ose
  - b. dëmi i shkaktuar ndaj specieve të mbrojtura dhe habitateve natyrore nga çdo veprimtari profesional e ndryshme nga ato të parashikuara në piken 3 (a) të këtij neni, si edhe nga çdo kërcënim i mundshëm i këtij dëmi si pasojë e kryerjes të këtyre veprimtarive, për shkak të gabimeve apo neglizhencës së zhvilluesit.
3. Keshilli i Ministrave miraton:
  - a. listën e veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin brenda kuptimit të pikes 2 të këtij neni;
  - b. kriteret, në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit ne mjedis;
  - c. masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar, dhe
  - d. metodën për specifikimin e shpenzimeve në lidhje me përcaktimin dhe eliminimin e kërcënimit dhe dëmit.
4. Zhvilluesi që kryen veprimtari të parashikuar në piken 3 (a) të këtij neni, i cili ka shkaktuar një dëm apo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për dëme ne mjedis është përgjegjës për këtë dëm.
5. Zhvilluesi është përgjegjës nëse:
  - a. nuk merr masat e nevojshme parandaluese;
  - b. nuk merr masat e nevojshme zhvenduese;
  - c. nuk njofton Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve në lidhje me rrezikun e dëmit ne mjedis, i cili mund të ishte shkaktuar pavarësisht nga masat e marra apo se dëmi mund të ketë ndodhur ose jo.
6. Në rast se dëmi ne mjedis nuk ka ndodhur, por ekziston një kërcënim i drejtpërdrejtë për një dëm të tillë, zhvilluesi merr menjëherë dhe pa vonesë, të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit ne mjedis. Nëse zhvilluesi nuk e përmbush këtë detyrim, Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve merr masat e nevojshme parandaluese dhe zhvilluesi është përgjegjës për të mbuluar koston perkatese.
7. Në rast se, pavarësisht nga masat e referuara në piken (6) të këtij neni, zhvilluesi nuk arrin të eliminojë kërcënimin e drejtpërdrejtë të dëmit ne mjedis, ai njofton menjëherë dhe pa vonesë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve. Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve:

- a. i kërkon zhvilluesit të sigurojë informacion në lidhje me çdo kërcënim për dëmet ne mjedis ose për rastet kur dyshohet për ekzistencën e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për dëme ne mjedis.
  - b. i kërkon zhvilluesit të marrë masat e nevojshme dhe i jep atij udhëzime në lidhje me masat parandaluese , dhe
  - c. merr masat e nevojshme parandaluese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik për të marrë masat e duhura me shpenzimet e zhvilluesit.
8. Në rast se dëmi ne mjedis ka ndodhur, zhvilluesi:
    - a. informon Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve për dëmin e shkaktuar,
    - b. kryen rehabilitimin e të gjithë dëmit, në përputhje me parimin ndotësi paguan,
    - c. merr të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin ne mjedis me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme ne mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore; dhe
    - d. merr të gjitha masat e parashikuara në piken 3 (c) të këtij neni.
  9. Në rast se disa zhvillues kryejnë një nga veprimtaritë e referuara në piken 3 (a) të këtij neni brenda te njejtit territor, ata mbajnë bashkarisht dhe reciprokisht përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kryerja e asaj veprimtarie ne perputhje me percaktimet e legjislacionit ne fuqi.
  10. Në rast se dëmi ne mjedis ka ndodhur, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve:
    - a. i kërkon zhvilluesit të sigurojë informacion të mëtejshëm në lidhje me dëmin e shkaktuar,
    - b. merr, i kërkon apo i jep udhëzime zhvilluesit për të marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin ne mjedis me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme ne mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore;
    - c. i kërkon zhvilluesit të marrë masat e nevojshme rehabilituese si dhe i siguron atij udhëzimet e duhura në lidhje me masat rehabilituese që duhet të merren;
    - d. merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik për të marrë masat e duhura me shpenzimet e zhvilluesit, në rast se zhvilluesi nuk e ka përmbushur këtë detyrim;
    - e. merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik për të marrë masat e duhura me shpenzimet e zhvilluesit, në rast se zhvilluesit nuk mund të identifikohet, apo nuk i kërkohet të përballojë shpenzimet siç parashikohet në pikat 2 dhe 3 të nenit 52.
  11. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve specifikon masat rehabilituese për sa i përket dëmit të shkaktuar ne mjedis.
  12. Në rastin e një dëmi të shkaktuar ne mjedis, zhvilluesi përcakton dhe propozon masat e nevojshme rehabilituese, siç parashikohet në piken 3 (c) të këtij neni, dhe ia paraqet ato Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve për miratim. Gjatë përcaktimit të masave rehabilituese, zhvilluesi merr parasysh që keto masa të jenë të përshtatshme dhe efikase në drejtim të eliminimit të të gjithë dëmit që i është shkaktuar mjedisit.
  13. Në rast se dëmi i shkaktuar ne mjedis është i tillë që masat rehabilituese nuk mund të merren njëherazi, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve përcakton masat prioritare dhe me kosto me te ulet qe do te ndermerren. Ne percaktimin e masave prioritare, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve merr parasysh natyrën, shkallën dhe rëndësinë e secilit prej dëmeve të shkaktuara ne mjedis, rrezikun ndaj shëndetit të njeriut si edhe aftësinë e rehabilitimit natyror të mjedisit.
  14. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është autoriteti kompetent për identifikimin e zhvilluesit që paraqet kërcënimin te drejtpërdrejtë për nje dëm te mundshem apo ka shkaktuar dëmin ne

mjedis, për vlerësimin e rëndësisë së dëmit të shkaktuar, si dhe për percaktimin e masave rehabilituese. Vlerësimi kryhet nga zhvilluesi apo nga ndonjë person tjetër fizik apo juridik.

## **Neni 49**

### **Shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese**

1. Zhvilluesi mbulon shpenzimet për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për demin që ai ka shkaktuar në mjedis.
2. Pavarësisht nga pika 1e këtij neni, zhvilluesi nuk bën kompensimin e shpenzimeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese në lidhje me demin e shkaktuar në mjedis në rast se ai vërteton që dëmi i shkaktuar apo kërcënimi për shkaktimin e një dëmi në mjedis:
  - a. është pasojë e një fenomeni natyror të paparashikuar dhe të pashmangshëm, i cili nuk mund të parandalohet apo të eliminohet;
  - b. është shkaktuar nga një palë e tretë dhe/ose ka ndodhur pavarësisht nga marrja e masave të duhura, dhe
  - c. është pasojë e zbatimit të vendimit të detyrueshëm të lëshuar nga një autoritet publik.
3. Zhvilluesi nuk është i detyruar të kompensojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese në rast se vërtetohet që dëmi në mjedis nuk është shkaktuar për faj të tij, por është shkaktuar nga:
  - a. një shkarkim apo veprimtari tjetër e autorizuar apo në përputhje me kushtet e percaktuara në lejen perkatese të mjedisit, dhe
  - b. një shkarkim, veprim, apo një produkt i përdorur apo i prodhuar nga veprimtaria, potenciali dëmtues i të cilit në momentin e shkaktimit të dëmit, ishte i panjohur nga shkenca.

## **Neni 50**

### **Kompensimi i dëmit në mjedis**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, kur vlereson se rehabilitimi dhe kthimi i mjedisit në gjendjen që kishte para se të shkaktohej dëmi është i pamundur, detyron zhvilluesin të paguaje kompensimin për demin e shkaktuar në mjedis.
2. Subjektet fizike apo juridike dhe shoqatat mjedisore në territorin që preket drejtpërdrejt apo vuan pasojat e dëmit të shkaktuar në mjedis, kanë të drejtë t'i kërkojë Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve të kërkojë nga zhvilluesi:
  - a. rikthimin e mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme,
  - b. kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis, në përputhje me sa parashikohet në këtë ligj, nëse rikthimi i mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme është i pamundur.

## **Neni 51**

### **Detyrimi për të Vene Paraprakisht në Dispozicion Fonde për Kompensimin e Dëmit**

1. Zhvilluesi që kryen veprimtarinë e referuar në nenin 48, pika 3 (a) e këtij ligji ve paraprakisht në dispozicion fondet e nevojshme për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis.
2. Keshilli i Ministrave miraton metodat dhe procedurat për sigurimin e fondeve të tilla si garancitë apo siguracionet e nevojshme.

## **Neni 52**

### **Burime te tjera per mbulimin e shpenzimeve për masat rehabilituese**

1. Buxheti i shtetit siguron burimet për rehabilitimin e dëmit, pasojat e të cilit duhen eliminuar në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 48, pika 3 (c) të këtij ligji, kur identifikimi i zhvilluesit është i pamundur.
2. Buxheti i shtetit siguron fondet financiare për korrigjimin e dëmit, kur dëmi i shkaktuar nga një veprimtari që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është shumë i madh.
3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, kur zhvilluesi i referuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni identifikohet më pas, i kërkon atij një rimbursim të shpenzimeve të bëra për eliminimin e pasojave të dëmit mjedisor brenda një periudhe prej pesë vitesh nga identifikimi i këtij te fundit.

## **Kreu 9**

### **INSTRUMENTAT DHE MJETET E POLITIKËS SË MBROJTJES SË MJEDISIT**

## **Neni 53**

### **Eko-Etiketa**

1. Ministria i jep Eko-Etiketën, si një shenjë dalluese dhe njohjeje, personave fizikë dhe juridikë që prodhojnë apo shpërndajnë produkte, të cilat, në krahasim me produktet apo shërbimet e barasvlershme, gjatë ciklit të jetës së tyre kanë ndikim më pak negativ dhe sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtje të mjedisit si dhe përdorim me efikasitet me të lartë të perberësve të tij. Produkte të tilla si ato ushqimore, pijet, produktet farmaceutike dhe pajisjet mjekësore profesionale apo shërbime të lidhura me to, nuk janë objekt i këtij neni.
2. Vlerësimi i efekteve më pak negative të referuara në pikën 1 të këtij neni ka të bëjë me përdorimin racional të burimeve natyrore dhe energjisë, reduktimin e shkarkimeve në mjedis, përdorimin e mbetjeve që kanë vlerë, apo me metoda të tjera që bëjnë të mundur shfrytëzimin e mbetjeve para depozitimit të tyre në fushën e depozitimit të mbetjeve dhe marrjes së masave të tjera për mbrojtjen e mjedisit.
3. Prodhuesi, importuesi, shpërndarësi i një prodhimi apo shërbimi mund të kërkojë të pajiset me Eko-Etiketën, e cila duhet të përmbajë bashkelidhur të gjitha dokumentet dhe provat që produkti në fjalë i përmbush kërkesat e përcaktuara.
4. Ministria mund ta heqë etiketën e dhënë kur personi i referuar në pikën 3 të këtij neni nuk vepron në pajtim me kërkesat, në bazë të të cilave është dhënë etiketa ose nuk i përmbush më kërkesat e përcaktuara për pajisjen me etiketë.
5. Ministria promovon përdorimin e produkteve dhe shërbimeve që kanë Eko-Etiketën përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit të konsumatorëve, prodhuesve, treguesve dhe publikut.
6. Keshilli i Ministrave miraton procedurën dhe kërkesat për pajisjen me Eko-Etiketën, mënyrën e dhënies, përdorimit dhe vlefshmërisë së saj, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit për lëshimin e Eko-Etiketave, pjesëmarrjen e individëve, shoqatave dhe autoriteteve publike në procedurën e dhënies së Eko-Etiketës, të referuar në pikën 1 të këtij neni.

## **Neni 54**

### **Skema e Eko-menaxhimit dhe Auditimit**

1. Ministria promovon përdorimin e skemës së eko-menaxhimit dhe auditimit si dhe lejon pjesëmarrjen vullnetare të organizatave me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e performancës mjedisore të tyre dhe palëve të tjera të interesuara.
2. Keshilli i Ministrave miraton procedurat dhe kërkesat për dhenien e skemave të eko-menaxhimit dhe auditimit.

## **Neni 55**

### **Marreveshjet vullnetare**

1. Organizata dhe grupe që përfaqesojnë interesa të caktuara, grupe zhvilluesish ose zhvillues individuale mund të lidhin marreveshje vullnetare me autoritetet perkatese në mënyrë që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i percaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përberës mjedisor.
2. Procedurat dhe kërkesat e tjera të detajuara për zbatimin e këtij neni miratohen nga Keshilli i Ministrave.
3. Secila prej këtyre marreveshjeve vullnetare është e detyrueshme nga momenti i nënshkrimit dhe mos-permbushja e kushteve të caktuara në të konsiderohet si një shkelje e kontrates.

## **Neni 56**

### **Eko-Dekorata**

1. Ministria i jep Eko-Dekorate personave fizikë dhe juridikë që kanë rezultate të matshme në mbrojtje të mjedisit dhe plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm si:
  - a. parandalimin e ndotjes së mjedisit,
  - b. përdorimin e Teknikave më të Mira të Disponueshme në proceset e prodhimit që kanë të bëjnë me mjedisin,
  - c. projektet për zhvillimin dhe kërkimin mjedisor;
  - d. krijimin e sistemit të trajnimit dhe edukimit të mbrojtjes së mjedisit;
  - e. kontributin individual për mbrojtjen e mjedisit apo në bashkëpunimin ndërkombëtar në këto fushë,
  - f. kontributin e shoqatave për promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit,
  - g. kontributet e veçanta për mbrojtjen e mjedisit.
2. Ministri cakton çdo vit Komisionin për dhenien e Eko-Dekorate.
3. Ministri miraton procedurën, mënyrën dhe kërkesat për dhënien e Eko-Dekoratave, llojeve të tyre, format dhe procedurat për paraqitjen e propozimeve, si dhe organizimin dhe funksionimin e Komisionit.
4. Ministria siguron fondet e nevojshme për perballimin e dekoratave mjedisore me natyrë monetare, të dhëna në përputhje me percaktimin e pikës 3 të këtij nga buxheti i vet, në përputhje me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

## **Neni 57**

### **Edukimi dhe Trajnimi per Mbrojtjen e Mjedisit**

1. Ministria pergjegjese per Arsimin dhe Ministria pergjegjese per Punen ne bashkëpunim me Ministrine nxisin, mbeshtesin dhe organizojne edukimin dhe trajnimin per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm permes sistemit arsimor dhe formave te trajnimit gjate gjithe jetes.
2. Ministria pergjegjese per Arsimin dhe Ministria pergjegjese per Punen ne bashkëpunim me Ministrine formulojne udhëzimet e duhura për një program mësimor dhe edukativ në përputhje me prioritetet dhe objektivat e programeve strategjike kombetare e nderkombetare ku Republika e Shqiperise eshte pale.

## **Neni 58**

### **Eko - taksat**

1. Eko - taksat mund te zbatohen per produkte dhe veprimtari te vecanta.
2. Eko – taksat te referuara ne piken 1 te ketij neni percaktohen ne perputhje me legjislacionin e posacem.

## **Kreu 10**

### **DISPOZITA INSTITUCIONALE**

#### **Seksioni 1:**

#### **Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve**

## **Neni 59**

### **Funksionet e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve ka këto funksione:
  - a. Është autoriteti kompetent për dhënien e lejeve perkatese te mjedisit në përputhje me dispozitat e këtij ligji, legjislacionin mbi lejet e mjedisit dhe ligjeve te tjera perkatese;
  - b. Hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - c. Përgatitjen dhe publikimin e Raporteve për Gjendjen e Mjedisit;
  - d. Kryerjen e kërkimeve shkencore dhe hulumtimeve të tjera;
  - e. Krijimin dhe menaxhimin e Sistemit të Informacionit të Mbrojtjes së Mjedisit;
  - f. Krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotsve;

- g. Sigurimin e informacionit mjedisor për publikun në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- h. Sigurimin e informacionit për publikun në lidhje me procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- i. Është autoriteti kompetent për sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- j. Është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet, dhe
- k. Funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posacem.

## **Neni 60**

### **Organizimi i Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është institucion qëndror publik në varësi të Ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përmes zyres qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'i referohemi si Agjencitë Rajonale të Mjedisit.
2. Qarqet në të cilat janë ngritur dhe funksionojnë Agjencitë Rajonale të Mjedisit caktohen nga Ministri.
3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve financohet nga buxheti i shtetit dhe burimet e veta.
4. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj të parashikuara në këtë ligj, nën përgjegjësinë e ministrit.
5. Keshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij Ligji, miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.

## **Neni 61**

### **Numri i punonjësve dhe struktura e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve**

1. Keshilli i Ministrave miraton numrin e punonjësve të Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve.
2. Kryeministri, me propozim të Ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi miraton strukturën dhe organiken e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve.



## **Neni 62**

### **Nëpunësit dhe punonjësit e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve**

1. Për nëpunësit e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil të parashikuara për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë ligj. Titullari i Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve është “eprori direkt” në përputhje me këto dispozita.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.
3. Ankimi ndaj akteve të Titullarit, të nxjerra në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij Neni behet drejtpërdrejtë në Gjykatë.

## **Seksioni 2:**

### **Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit**

## **Neni 63**

### **Funksionet e Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit**

1. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit ka këto funksione:
  - a. Është autoriteti përgjegjes për sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në këtë ligj, dhe legjislacionin e referuar në të;
  - b. Është autoriteti përgjegjes për sigurimin e përmbushjes së kushteve të lejes perkatese të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit për lejet e mjedisit;
  - c. Është autoriteti përgjegjes për përgatitjen e planeve vjetore të inspektimit dhe për sigurimin e zbatimit të tyre;
  - d. Është autoriteti përgjegjes për sigurimin e informacionit për publikun në lidhje me çështjet mjedisore në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - e. Është autoriteti përgjegjes për sigurimin e informacionit për publikun në lidhje me procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - f. Është autoriteti përgjegjes për sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
2. Inspektimi për zbatimin e këtij ligji përsa i përket tregtimit të produkteve, lëndëve të para, substancave kimike dhe paketimit të kimikateve, si dhe etiketimit të produkteve dhe informacionit që përmban paketimi lidhur me ndikimet në mjedis kryhet nga strukturat përkatëse të Mbikëqyrjes

të Tregut, Inspektoriatit Sanitar, Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit.

#### **Neni 64**

##### **Organizimi i Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit**

1. Inspektoriatit Kombëtar i Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të Ministrit, që ushtron juridiksionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përmes zyres qendrore dhe degëve të tij rajonale (në qarqe), të cilave këtu e më pas do t'i referohemi si Inspektoriatet Rajonale të Mjedisit.
2. Qarqet në të cilat janë krijuar dhe funksionojnë Inspektoriatet Rajonale të Mjedisit, caktohen nga Ministri.
3. Inspektoriatit Kombëtar i Mjedisit financohet nga buxheti i shtetit dhe burimet e veta.
4. Inspektoriatit Kombëtar i Mjedisit ka pavarësi të plotë në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të tij të parashikuara në këtë ligj.
5. Inspektoriatit Kombëtar i Mjedisit përfshin:
  - a. inspektorët e referuar në ligjin nr. 8093, datë 21.3.1996 “Per rezervat Ujore”.
  - b. inspektorët e referuar në Ligjin nr. 8897, date 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
6. Keshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij Ligji, miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e tij me institucione të tjera.

#### **Neni 65**

##### **Numri i punonjësve dhe struktura e Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit**

1. Keshilli i Ministrave miraton numrin e punonjësve të Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit.
2. Kryeministri me propozim të Ministrit miraton strukturën dhe organiken e Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit.

#### **Neni 66**

##### **Nëpunësit dhe punonjësit e Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit**

1. Për nëpunësit e Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil të parashikuara për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë ligj. Titullari i Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit është “eprori direkt” në përputhje me këto dispozita.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit që kryejnë detyra të karakterit mbështetës i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

3. Ankimi ndaj akteve të Titullarit, të nxjerra në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij Neni behet drejtpërdrejtë në Gjykatë.

## **Neni 67**

### **Detyrat e Përgjithshme të Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit**

1. Inspektoriatit Kombëtar i Mjedisit përgatit planet vjetore të inspektimit.
2. Inspektimet mund të jenë:
  - a. inspektime rutinë, domethënë pjesë e planit vjetor të inspektimit, ose
  - b. jo-rutinë, domethënë
    - i. në lidhje me lëshimin e lejes perkatese të mjedisit,
    - ii. në përgjigje të një ankese
    - iii. për hetimin e aksidenteve
    - iv. për hetimin e rasteve të mos-përputhjes.
3. Veprimtaria që i nënshtrohet inspektimit rutinë njoftohet paraprakisht para inspektimit.
4. Veprimtaria që i nënshtrohet inspektimit jo-rutinë mund të njoftohet ose jo paraprakisht para inspektimit.
5. Inspektimi përfshin:
  - a. Kontrollin dhe nxitjen e përputhjes së veprimtarive me kërkesat e legjislacionit përkatës;
  - b. Monitorimin e ndikimit të veprimtarive mbi mjedisin për të përcaktuar nëse kërkohen veprime të mëtejshme, duke përfshirë shfuqizimin e lejes perkatese të mjedisit, për të siguruar përputhjen me legjislacionin përkatës;
  - c. Kontrollin nëse po përmbushen Standardet e Cilesise të Mjedisit;
  - d. Verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë;
  - e. Kontrollin dhe promovimin e përputhjes me kërkesat e lejes perkatese të mjedisit;
  - f. Verifikimin dhe vlerësimin e monitorimit të përputhjes të bërë nga zhvilluesi i veprimtarisë;
  - g. Vlerësimin e aktiviteteve të kryera në veprimtarinë e dhënë;
  - h. Kontrollin e mjedisve dhe pajisjeve përkatëse, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre;
  - i. Kontrollin dhe vlerësimin e menaxhimit të mjedisit nga ana e veprimtarisë;

- j. Kontrollin e dokumenteve të mbajtura nga zhvilluesi i veprimtarisë.
  - k. Kontrollin dhe nxitjen e perputhshmerise me marreveshjet vullnetare.
6. Inspektori i mjedisit bashkërendon orarin e inspektimit në terren me autoritete te tjere inspektues ne rastet kur keto autoritete kane planifikuar inspektim te te njejtës veprimtari ne te njejtën kohe
  7. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit, në përputhje me kërkesat e specifikuara në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, ushtron kontroll në drejtim të zbatimit të detyrave të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave dhe programit për rehabilitimin e zonës së ndotur.
  8. Inspektori i mjedisit mund të kryejë edhe detyra të tjera të percaktuara ne ligje të tjera te posacme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

## **Neni 68**

### **Kompetencat e inspektorëve**

1. Inspektori i Mjedisit, pas paraqitjes së dokumentit që vërteton autoritetin e tij, nëse kjo kërkohet, mund të ushtrojë secilin nga funksionet e parashikuara në piken 2 te ketij neni, për të përmbushur funksionet e Inspektoriatit të Mjedisit.
2. Kompetencat e inspektorit të mjedisit janë:
  - a. Te hyje në çdo kohë në çdo mjedis ku është duke u kryer apo ku ai ka arsye për të besuar se po kryhet një veprimtari e referuar në kete ligj;
  - b. Te hyje në çdo kohë në çdo mjedis të një veprimtarie të referuar në kete ligj, qe është duke u kryer apo për të cilën ai ka arsye për të besuar se po kryhet, kur sipas mendimit të tij, ekziston rrezik potencial per ndotjeje serioze të mjedisit;
  - c. Te kryejë ekzaminimin apo hetimin e nevojshëm në përputhje me rrethanat;
  - d. Të japë udhëzimet që mjediset ku ai ka kompetencë të hyjë, çdo pjesë e tyre apo gjithçka gjendet brenda tyre, të mos preket përse kohë që kjo është e nevojshme për ekzaminimin apo hetimin;
  - e. Te kryejë matjet dhe fotografite e nevojshme dhe te marre këto të dhëna në mënyrën që ai e konsideron si më të përshtatshme për ekzaminimin apo hetimin;
  - f. Te marre mostra të çdo sendi, substance të gjetur dhe/ose të ajrit, ujit dhe tokës në mjediset e brendshme te veprimtarise apo ne territorin ku ajo shtrihet, ku ai ka kompetencë të hyjë.
  - g. Te kërkoje t'i dorëzohen dokumente me të dhëna që mbahen në bazë të këtij Ligji si edhe të inspektojë dhe të bëjë kopje të të gjitha këtyre dokumenteve apo pjesëve të caktuara të tyre.
3. Inspektori, në rast se merr në posedim nga mjediset e parashikuara në piken 2 (f) te ketij neni një send apo substancë, njofton permes nje personi përgjegjës, ose ne pamundesi, vendos në një vend

të dukshëm një njoftim ku për atë send apo substancë jepen detaje të mjaftueshme identifikuese dhe ku deklarohet se ai e ka marrë atë në posedim në përputhje me këtë ligj.

4. Inspektori, në rast se planifikon të marrë në posedim një substancë sipas pikes 2(f), nëse kjo është e praktikisht e mundur për të, ai merr një mostër të saj dhe një pjesë të kësaj mostre, të shënuar në mënyrë të mjaftueshme për të bërë identifikimin e substancës, ia jep personit përgjegjës në mjedisin në fjalë.

## **Neni 69**

### **Detyrimi për të siguruar përputhshmerine**

1. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit ka për detyrë të ndërmarrë veprime të tilla, të cilat në bazë të këtij ligji mund të jenë të nevojshme për të siguruar përputhshmerine me kërkesat e kushteve të lejes perkatëse të mjedisit.
2. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit ka për detyrë të ndërmarrë veprime të tilla, të cilat, në bazë të këtij ligji, mund të jenë të nevojshme për të siguruar përputhshmerine me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit për ndërtimet, për veprimtaritë e planifikuara, për të cilat nevojitet kryerja e vleresimit të ndikimit në mjedis.

## **Neni 70**

### **Njoftimet për Përputhshmerine**

1. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit, në rast se vlerëson se zhvilluesi ka shkelur, po shkel apo ka gjasa të shkelë kushtet e lejes perkatëse të mjedisit, i dërgon atij Njoftimin për Përputhshmerine.
2. Njoftimi për Përputhshmerine bëhet me shkrim dhe:
  - a. Përkrahet çështjet që përbëjnë shkelje apo ato që tregojnë që ka gjasa që të ndodhë shkelje;
  - b. Përkrahet hapat që merren nga zhvilluesi për të korrigjuar shkeljen apo për të korrigjuar çështjet që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelje;
  - c. Përcakton periudhën kohore kur merren këto hapa.
3. Njoftimi për Përputhshmerine mund të përfshijë hapat që merren për të përmbushur kushtet e lejes perkatëse të mjedisit gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të aktivitetit si dhe hapat për korrigjimin e efekteve të ndotjes së shkaktuar nga shkelja.

## **Neni 71**

### **Njoftimet per Pezullimin**

1. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit, në rast se është i mendimit që ndërtimi apo kryerja e një veprimtarie, ose ndërtimi apo kryerja e saj në një mënyrë të caktuar, përbën rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, ai i dërgon Njoftimin për Pezullimin e asaj veprimtarie, pronarit të sendit apo zhvilluesit të veprimtarisë, sipas rastit.
2. Njoftimi për Pezullimin bëhet me shkrim dhe në të:
  - a. Përcaktohet rreziku i mundshëm që ka lidhje me ndërtimin apo kryerjen e veprimtarisë;
  - b. Përcaktohen hapat që merren për ta shmangur atë rrezik;
  - c. Përcaktohet periudha kohore në të cilën merren këto hapa;
  - d. Deklarohet që leja perkatese e mjedisit apo pjese të veçanta të saj nuk janë më të vlefshme, derisa të hiqet Njoftimi për Pezullimin.
3. Leja perkatese e mjedisit nuk është më, plotësisht apo pjesërisht, e vlefshme siç është përcaktuar në Njoftimin për Pezullimin, në momentin që pronari i sendit apo zhvilluesi ka marrë këtë njoftim.
4. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit mund ta tërheqë Njoftimin për Pezullimin në çdo kohë në rast se ai vlerëson që janë marrë hapat e kërkuara nga Njoftimi për Pezullimin për shmangien e rrezikut të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit.

## **Seksioni 3:**

### **Dispozita të tjera Institucionale**

## **Neni 72**

### **Organet Këshillimore**

1. Për të mbështetur veprimtarinë e Ministrisë, pranë tij mund të ngrihen organe këshillimore.
2. Këshilli i Ministrave miraton përberjen, detyrat, funksionet, formën e organizimit si dhe shpenzimet për ngritjen dhe funksionimin e organeve këshillimore.

## **Neni 73**

### **Fondi Mjedisor**

1. Për të mbështetur veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit mund të krijohet një fond mjedisor.

2. Burimi i te ardhurave, menyra e funksionimit dhe perdorimit te ketij fondi percaktohet me ligj te posacem.

## **Kreu 11**

### **KUNDRAVAJTJET**

#### **Neni 74**

##### **Kundravajtjet**

1. Shkeljet e mëposhtme te këtij ligji, përbëjnë vepër penale:
  - a. Zhvilluesi qe i jep informacion fals apo te shtremberuar Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, Inspektoratit Kombetar te Mjedisit, Ministrise apo cdo autoriteti publik te referuar ne kete ligj, eshte pergjegjes per vepren penale te parashikuar nga Neni 186 i Kodit penal;
  - b. Perfaqesuesi i autoritetit publik qe i jep informacion fals apo shtremberon, demton, ndalon, fsheh, fshin apo shkaterron te dhena, fakte apo informacion te mbajtur prej tij, per te cilin publiku ka te drejten e posedimit, sipas percaktimit te nenit 43 te ketij ligji, eshte pergjegjes per vepren penale te parashikuar nga Neni 186 dhe 248 te Kodit Penal;
  - c. Cdo person fizik apo juridik qe nderhyn, pengon apo kundershton kryerjen e detyrave te ngarkuara nga inspektori i mjedisit sipas ketij ligji dhe legjislacioni te cilit ai i referohet sipas percaktimit te nenit 62 dhe 63 te ketij ligji, eshte pergjegjes per vepren penale te parashikuar nga Neni 235 te Kodit Penal;
2. Shkeljet e mëposhtme te këtij ligji, qe nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
  - a. Mos-dhenia e informacionit mbi Shkarkimin dhe Transferimin e Ndotsve nga zhvilluesi sipas percaktimit te nenit 31 te ketij ligji denohet me gjobe ne vleren nga \_\_\_\_\_ milion leke deri ne \_\_\_\_\_milion leke duke u shtuar me vleren \_\_\_\_\_leke cdo dite deri ne plotesimin e detyrimit;

- b. Mos-permbushja e kerkesave mbi prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozon-holluese si dhe importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve dhe pajisjeve që permbajnë keto substanca, sipas percaktimit të nenit 34 të këtij ligji, denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vlerën \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri në plotesimin e detyrimit;
- c. Mos-permbushja e kerkesave për leshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetiki, për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, sipas percaktimit të nenit 35 të këtij ligji, denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vlerën \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri në plotesimin e detyrimit;
- d. Mos-permbushja e kerkesave për hedhjen në treg dhe përdorimin, reduktimin e shkarkimeve, minimizimin dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm, sipas percaktimit të nenit 36 të këtij ligji, denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vlerën \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri në plotesimin e detyrimit;
- e. Mos-permbushja e kerkesave për shkarkimin e ererave të pakëndeshme nga aktivitetet e reja dhe ekzistuese, sipas percaktimit të nenit 37, të këtij ligji denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vlerën \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri në plotesimin e detyrimit;
- f. Personi i autorizuar që kur kryen monitorimin e mjedisit, nuk ploteson sa më shumë të jetë e mundur kërkesat për minimizimin e nderhyrjes mbi përdorimin e tokës, dhe pas kryerjes së veprimtarisë nuk ploteson sa më shumë të jetë e mundur kërkesat për rikthimin e tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sipas percaktimit të nenit 42 të këtij ligji, denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vlerën \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri në plotesimin e detyrimit;
- g. Mos-marrja e masave të nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis si dhe mos-informimi i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve mbi mundësinë e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për një dëm të tillë nga Zhvilluesi, sipas percaktimit të nenit 48, pika 6 e këtij ligji, pavaresisht nga detyrimi i tij për marrjen e masave parandaluese të dëmit në mjedis, sipas percaktimit të nenit 49, pika 1 e këtij ligji, denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke;
- h. Mos-informimi i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve nga Zhvilluesi se megjithë masat e marra në përputhje me percaktimin e nenit 48, pika 6 e këtij ligji, kërcënimi i drejtpërdrejtë i dëmit në mjedis nuk është shmangur, sipas percaktimit të nenit 48, pika 7 e këtij ligji, pavaresisht nga detyrimi i tij për siguruar paraprakisht fondet për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis, sipas percaktimit të nenit 51 të këtij ligji, denohet me gjobe në vlerën nga \_\_\_\_\_ milion leke deri në \_\_\_\_\_ milion leke;



- i. Mos-permbushja e kerkesave te nenit 48, pika 8 e ketij ligji nga zhvilluesi, pavaresisht nga detyrimi i tij per te rikthyer mjedisin ne gjendjen e meparshme, rehabilitimin e mjedisit, kompensimin e demit te shkaktuar apo per te marre masa te tjera te percaktuara ne kete ligj, denohet me gjobe ne vleren nga \_\_\_\_\_ milion leke deri ne \_\_\_\_\_ milion leke;
  - j. Mos-perdorimi i Eko-Etiketës nga zoteruesi i saj, sipas percaktimit te nenit 53 te ketij ligji, denohet me gjobe ne vleren nga \_\_\_\_\_ leke deri ne \_\_\_\_\_ leke. Kryerja për here te dyte nga i njëjti subjekt i te njejes kundravajtje shoqerohet me heqjen e Eko-Etiketës sipas percaktimit te nenit 53, pika 4 e ketij ligji;
  - k. Mos-perdorimi i skemës së eko-menaxhimit dhe auditimit sipas percaktimit te nenit 54 te ketij ligji denohet me gjobe ne vleren nga \_\_\_\_\_ leke deri ne \_\_\_\_\_ leke duke u shtuar me vleren \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri ne korrigjimin e mos-perputhjes;
  - l. Mos-plotesimi nga zhvilluesi, i kerkesave te percaktuara ne njoftimin e përputhshmerise, brenda afatit te percaktuar ne te, sipas percaktimit te nenit 70 te ketij ligji, denohet me gjobe ne vleren nga \_\_\_\_\_ milion leke deri ne \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vleren \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri ne plotesimin e detyrimit;
  - m. Mos-plotesimi nga pronari i sendit apo zhvilluesi i veprimtarise, i kerkesave te percaktuara ne njoftimin e pezullimit brenda afatit te percaktuar ne te, sipas percaktimit te nenit 71 te ketij ligji, denohet me gjobe ne vleren nga \_\_\_\_\_ milion leke deri ne \_\_\_\_\_ milion leke duke u shtuar me vleren \_\_\_\_\_ leke cdo dite deri ne plotesimin e detyrimit;
3. Pavaresisht nga denimi i parashikuar ne germen "l" dhe "m" te pikes 2 me sipër, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve me propozimin e Inspektoriatit Kombetar te Mjedisit mund te pezulloje apo heqe lejen perkatese te mjedisit per te gjithë veprimtarine apo pjese te saj.
  4. Inspektorati Kombetar i Mjedisit mund te ndërmarre sanksionet e parashikuara ne këtë nen ne cdo kohe, por jo me vone se pese vite kalendarike nga data e kryerjes se shkeljes.
  5. Inspektorati Kombetar i Mjedisit i njofton me shkrim subjektit te shkeljes, aktin e konstatimit dhe vendos sanksionet, brenda 60 dite kalendarike nga momenti qe Inspektorati Kombetar i Mjedisit ben konstatimin e kundravajtjes.
  6. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit ne fuqi.
  7. Gjoha paguhet brenda një periudhe prej 35 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përvese kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit ne fuqi
  8. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, me propozimin e Inspektoriatit Kombetar te Mjedisit, ne rastet kur gjoha nuk eshte paguar brenda afatit te percaktuar ne piken 7 te ketij neni, mund te pezulloje lejen perkatese mjedisore deri ne pagesen e gjobes.

9. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit, ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse sipas legjislacionit ne fuqi.
10. Inspektoriati Kombetar i Mjedisit arkëton dhe administron të ardhurat nga gjobat dhe interesat perkatese, sipas legjislacionit në fuqi.
11. Zbatimi i kundravajtjeve administrative nuk e shmang subjektin perkates nga detyrime te tjera te percaktuara ne kete ligj si dhe pergjegjesia civile per demin e shkaktuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

## **Kreu 12**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 75**

##### **Propozimi i akteve nënligjore**

1. Ministri propozon aktet nënligjore qe miratohen nga Këshilli i Ministrave ne zbatim te këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave dhe/apo ministri, miratojnë aktet nënligjore sipas përcaktimit dhe ne zbatim te këtij ligji, brenda një periudhe 2 vjecare nga hyrja ne fuqi.

#### **Neni 76**

##### **Aktet Nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 25, 26, 30, 31, 34, 35, 36, 38, 40, 41, 44, 46, 51, 53, 54, 55, 60, 61, 64, 65 dhe 72 të këtij ligji.
2. Ministri ngarkohet te nxjerre aktet nenligjore ne zbatim te neneve 56, 60, 64 dhe 79 te ketij ligji.

#### **Neni 77**

##### **Amendime**

1. Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 860, date 20.12.2006 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm” miratuar ne zbatim te nenit 8 te Ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, do te vazhdoje te kete efekt dhe do te referohet si ne zbatim te nenit 36 te ketij ligji.
2. Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 847, date 29.11.2007 “Per miratimin e Strategjise Ndersektoriale te Mjedisit” miratuar ne zbatim te nenit 9 te Ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, do te vazhdoje te kete efekt dhe do te referohet si ne zbatim te nenit 20 te ketij ligji.

3. Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 543, date 23.06.2005 “Per miratimin e listes se pajisjeve, qe perdorin lende ozonholluese, te cilat ndalohen te prodhohen e te importohen, si dhe rregullat e procedurat e zevendesimit te lendeve ozonholluese ne paisjet ekzistuese” miratuar ne zbatim te nenit 17 te Ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, do te vazhdoje te kete efekt dhe do te referohet si ne zbatim te nenit 34 te ketij ligji.
4. Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 1189, date 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” miratuar ne zbatim te nenit 53 te Ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, do te vazhdoje te kete efekt dhe do te referohet si ne zbatim te nenit 40 te ketij ligji.
5. Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 24, date 22.01.2004 “Per veprimtarine e Inspektoriatit te Mjedisit” miratuar ne zbatim te nenit 61 te Ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, do te vazhdoje te kete efekt dhe do te referohet si ne zbatim te nenit 64 te ketij ligji.
6. Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 42, date 16.01.2003 “Për krijimin e Komitetit Ndërsektorial, për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin” miratuar ne zbatim te nenit 76 te Ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, do te vazhdoje te kete efekt dhe do te referohet si ne zbatim te nenit 72 te ketij ligji.

### **Neni 78**

#### **Shfuqizime**

1. Ligji nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen ne fuqi te ketij ligji.

**[kjo alternative duhet te perdoret ne rast se te gjithë ligjet e pergatitur nga INPAEL shkojne per miratim ne kuvend si nje pakete ligjore]**

### **Neni 78 [alternative]**

#### **Shfuqizime**

1. Ligji nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, me perjashtim te sa parashikohet ne pikat 2 deri ne 7 te ketij neni.
2. Pa rene ndesh me nenin 23 te ketij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 te Ligjit nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, vazhdojne te kene efekt persa i takon Vleresimit Strategjik Mjedisor deri ne momentin e shfuqizimit te tyre me ligj te posacem.
3. Pa rene ndesh me nenin 23 te ketij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 te Ligjit nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, vazhdojne te kene efekt persa i takon Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis deri ne momentin e shfuqizimit te tyre me ligj te posacem.

4. Pa rene ndesh me nenin 28 te ketij ligji, nenet 34, 36-46 dhe 51/1 te Ligjit nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, mbi lejen, autorizimin dhe pelqimin mjedisor, vazhdojne te kene efekt deri ne momentin e shfuqizimit te tyre me ligj te posacem.
5. Pa rene ndesh me nenin 29 te ketij ligji, neni 49 te Ligjit nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, mbi parandalimin e aksidenteve industriale, vazhdon te kete efekt deri ne momentin e shfuqizimit te tij me ligj te posacem.
6. Pa rene ndesh me nenin 32 te ketij ligji, nenet 20-24 te Ligjit nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, lidhur me menaxhimin e mbetjeve, vazhdojne te kene efekt deri ne momentin e shfuqizimit te tyre me ligj te posacem.
7. Pa rene ndesh me nenin 33 te ketij ligji, nenet 20 dhe 23 te Ligjit nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, lidhur me importimin dhe tranzitin e lendeve te rrezikshme, vazhdojne te kene efekt deri ne momentin e shfuqizimit te tyre me ligj te posacem.

**[kjo alternative duhet te perdoret ne rast se te gjithe ligjet e pergatitur nga INPAEL nuk shkojne per miratim ne kuvend si nje pakete ligjore]**

### **Neni 79**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Funksionet e dhena nga ky ligj Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, dhe ne menyre te vecante ato te percaktuara ne nenin 59 te tij, do te kryhen nga Ministria ne bashkepunim me Agjencine e Mjedisit dhe Pyjeve per nje periudhe jo me te madhe se kater vjete.
2. Periudha kalimtare sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, perfundon sipas percaktimit me Udher te Ministrit i cili publikohet ne “fletore zyrtare”

### **Neni 80**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.